

Lipjani nuk i shpalos si duhet pasqyrat financiare

Arian Duriqi

LIPJAN, 15 KORRIK - Disa informacione shpjeguese të kërkuara nga Raportimi Financiar sipas bazës të parasë së gatshme mbi kontabilitetin dhe Rregullës financiare 07/2011 mbi Raportimin vjetor të organizatave buxhetore nuk janë bërë nga Komuna e Lipjanit në përgatitjen e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011. Auditori i pavarur ka gjetur se në veçanti në Raportin vjetor, ishte lënë pa u shpalosur ose nuk janë shpalosur siç duhet pasqyrat financiare. "Pagesat nga palët e treta, në nenin 12 të Pasqyrës për pranime të parasë së gatshme dhe pagesa nuk janë shpalosur në mënyrën e duhur dhe të plotë për vitin e përfunduar më 2011. Detyrimet kontingjente nuk janë shpalosur në mënyrë të duhur dhe complete, kurse Komuna nuk e kishte bërë një vlerësim të duhur të vlerës lidhur me bazën ligjore të detyrimeve kontingjente të ngritura kundër Komunës. Komuna e Lipjanit kishte raportuar vlerën prej 22.704 euro dhe për të cilën zyra e Avokatit të Komunës nuk beson se kjo vlerë e ngritur do të rrjedhë dhe të njihet si detyrim kontingjent", thuhet në raportin e Auditorit për vitin 2011. Mes tjerash, sipas raportit, del po ashtu se vlera e arkëtimit (të shpalosura si të hyra të mbledhura nga Komuna) nuk janë përfunduar në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011. "Komuna nuk e ka shpalosur vlerën e fituar nga shpronësimi i tokës gjatë vitit 2011. Ligji nr. 03/L-221 - veprimet e raportuara, ta ndërmarra dhe të propozuara për



gjetjet dhe rekomandimet e auditorit për vitin 2010 nuk janë kryer në mënyrën e duhur. Edhe informacionet krahasuese për vitet 2010 dhe 2009 nuk janë paraqitur në mënyrën e duhur, derisa përmbledhja e pasurisë kapitale jofinanciare nuk është kompletuar siç duhet dhe nuk krahasohen dhe barazohen me vitet e mëparshme", ka shkruar auditori. Më tej, auditori flet po ashtu se si Komuna nuk e ka regjistruar si duhet as pronën, impiantet dhe pajisjet në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës

(të referuara si "KFMS"). "Burimi kryesor i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është SIMFK. Megjithatë, pasi që SIMFK nuk është duke u përdorur për regjistrimin e pagesave nga palët e treta, pronën, pajisjet dhe impiantet ose të arkëtueshmet, nuk mund të shfrytëzohet i njëjti për të përgatitur pasqyra financiare gjithëpërfshirëse", thuhet në raport. Mirëpo edhe pse kryetari i Komunës dhe zyrtari financiar kanë nënshkruar deklaratat lidhur me prezantimin e pasqyrave finan-

ciare, Komuna nuk ka qenë në gjendje të dorëzojë një draft final të pasqyrave financiare në gjuhën serbe deri në fund të auditimit. "Komuna nuk ka zbatuar një sistem gjithëpërfshirës dhe të automatizuar të faturimit dhe nuk mban lista apo llogari të veçanta e complete për të gjithë debitorët e saj në lidhje me taksat e ndryshme, pasi që vetëm mbledhja e të hyrave është e regjistruar. Megjithëse të arkëtueshmet duhet të shpalosen në plotshmëri, një shpalosje e tillë nuk është bërë në pasqyrat financiare të

Sipas raportit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, edhe pse kryetari i Komunës dhe zyrtari financiar kanë nënshkruar deklaratat lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk ka qenë në gjendje të dorëzojë një draft final të pasqyrave financiare në gjuhën serbe deri në fund të auditimit

komunës", ka shkruar auditori. E lidhur me Raportin e sivjetmë të auditorit për vitin e shkuar ka pasur reagim edhe të shoqërisë civile në Lipjan. Organizata Joqeveritare Youth Association for Human Rights (YAHR) nëpërmjet një komunikate ka shprehur shqetësimin lidhur me vërejtjet e raportit të auditorit të pavarur për vitin 2011. "Ftojme autoritetet komunale që t'i marrin seriozisht vërejtjet që janë dhënë dhe të punojnë në përmirësim të tyre", ka thënë Bekim Krasniqi, udhëheqës në YAHR.